

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1682 Prot

Durrës, më: 08.07.2025

V E N D I M

Nr. 79, datë 08/07 2025

PËR

"MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATSHKURTËR PËR PROCEDURËN E REKRUTIMIT TË STUDENTËVE TË HUAJ NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM Nr. 279, datë 21.05.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në republikën e shqipërisë", të ndryshuar; në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; në Urdhërin e Rektorit Nr. 291, datë 30.06.2025 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Afatshkurtër për procedurën e rekrutimit të studentëve të huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", si dhe në shkresën me Nr. 1604/1 prot., datë 07.07.2025 të Zv. Rektor për çështjet mësimore, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë Afatshkurtër për procedurën e rekrutimit të studentëve të huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2025-2026, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
3. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
 - Drejtoria e Projekteve
 - Drejtoria Juridike
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

**STRATEGJIA AFATSHKURTËR
PËR PROCEDURËN E REKRUTIMIT TË
STUDENTËVE TË HUAJ NË
UNIVERSITETIN
"ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
PËR VITIN AKADEMIK
2025-2026**

Durrës 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Hyrje

Në një botë akademike gjithnjë e më të globalizuar, roli i universiteteve publike në tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë është rritur ndjeshëm. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD), bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.67 datë 04.06.2025 për "*Miratimin e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës 2025-2027"*, ka arritur një fazë kyçe zhvillimi të lartë, ku ndërkombëtarizimi nuk është më vetëm si objektivi strategjik afatgjatë për UAMD-në, por një domosdoshmëri për shkak të kërkesave që student të huaj po tregojnë interes për të studiuar në UAMD, qoftë në kuadër të programeve të Bashkimit Europian si Erasmus +, por edhe në programe të tjera që ofron UAMD.

Përballë sfidave të konkurrencës rajonale dhe globale në fushën e arsimit të lartë, është bërë gjithnjë e më e qartë se UAMD duhet të adoptojë mekanizma funksionalë dhe procedura të qarta për të përfshirë studentët e huaj në ofertën akademike të institucionit. Pavarësisht cilësisë në rritje të programeve të studimit dhe përpjekjeve për rritjen e profilit ndërkombëtar, mungesa e një strukture të dedikuar për aplikimet dhe ndjekjen e studentëve të huaj ka krijuar boshllëqe funksionale që kërkojnë adresim të menjëhershëm.

Në këtë kontekst, hartimi i një strategjie afatshkurtër për vitin akademik 2025–2026 është një hap i domosdoshëm për të filluar zbatimin e një praktike të mirëfilltë, që do të mundësojë jo vetëm rritjen e numrit të aplikimeve nga studentë të huaj, por edhe menaxhimin efikas të procesit të pranimit dhe ndjekjes së tyre gjatë gjithë ciklit të studimeve.

Strategjia e propozuar ka për qëllim të ndërtojë një procedurë të përkohshme, por funksionale, e cila do të mbulojë të gjithë ciklin e aplikimit – nga publikimi i informacionit, prezantimi me ofertën tonë akademike si dhe informacion për jetë studentore në UAMD, mbledhja dhe verifikimi i dokumentacionit, komunikimi me aplikantët, deri te vendimmarrja për pranimin, ndjekja administrative dhe orientimi i tyre në procesin e integritimit në jetën akademike në UAMD. Duke qenë se ndërtimi i një sistemi të plotë dhe të automatizuar CRM kërkon kohë dhe investim, kjo strategji fokusohet në një zgjidhje të ndërmjetme, manuale, të bazuar në kapacitetet ekzistuese të stafit akademik, administrativ dhe teknologjisë në dispozicion, me synimin që të shërbejë si urë drejt një sistemi të plotë e të integruar në të ardhmen e afërt.


Në këtë mënyrë, strategjia e paraqitur përbën një platformë të përkohshme, por të domosdoshme, e cila i mundëson universitetit të bëjë hapa konkretë drejt ndërkombëtarizimit dhe të sigurojë një fillim të suksesshëm të pranimeve të para të strukturuara të studentëve të huaj për vitin akademik 2025–2026. Kjo është një mundësi reale për ta vendosur UAMD në hartën e institucioneve të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

arsimit të lartë me ndikim rajonal dhe për të promovuar modelin e një universiteti modern,
gjithëpërfshirës dhe global në qasje.

[Handwritten signatures]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	1
2. Qëllimi i Strategjisë.....	2
3. Objektivat dhe Rezultatet e Pritshme.....	3
4. Përshkrimi i Procedurës së Aplikimit.....	4
5. Hapat Teknikë dhe Logjistikë të Ndjekjes së Aplikimeve.....	5
6. Menaxhimi i Komunikimit dhe Promovimit	6
7. Zgjidhje e Përkohshme dhe Sistemi i Synuar.....	7
8. Baza Ligjore e VKM Nr.858, date 29.12.2021.....	8
9. Përfundime dhe Rekomandime.....	9

Qëllimi i Strategjisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Qëllimi i kësaj strategjie është të vendosë një strukturë të qartë, funksionale dhe efektive për pranimin dhe ndjekjen e studentëve të huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës për vitin akademik 2025–2026. Strategjia synon të krijojë një proces të formalizuar që nis me publikimin e informacionit të qartë dhe të aksesueshëm për studentët e huaj, vazhdon me grumbullimin e aplikimeve dhe dokumentacionit përkatës, dhe përfundon me vendimmarrjen, komunikimin zyrtar dhe ndjekjen pas pranimin. Ajo parashikon ndërhyrje të menjëhershme në aspektin organizativ, teknologjik dhe logjistik, për të ofruar një procedurë të qasshme dhe të menaxhueshme, edhe në kushtet kur mungon ende një sistem i integruar CRM.

Kjo qasje e përkohshme, por e qëllimshme, do të shërbejë si një fazë tranzitore drejt ndërtimit të një sistemi të plotë digjital, duke mundësuar një rritje të menjëhershme të aksesit dhe interesit nga studentët ndërkombëtarë. Njëkohësisht, synohet përmirësimi i imazhit institucional të UAMD-së si një universitet serioz, i organizuar dhe mikpritës për studentët e huaj.

Objektivat dhe Rezultatet e Pritshme

Strategjia afatshkurtër për rekrutimin e studentëve të huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës synon të vendosë bazat për një proces të strukturuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të ndërkombëtarizimit. Objektivat kryesore përfshijnë: rritjen e numrit të aplikimeve ndërkombëtare për vitin akademik 2025–2026; krijimin e një infrastrukture të përkohshme funksionale për menaxhimin e aplikimeve; ndërtimin e një mekanizmi komunikimi dhe orientimi për studentët e huaj; dhe konsolidimin e prezencës së UAMD në hapësirat promovuese ndërkombëtare të arsimit të lartë. Gjithashtu, strategjia synon përmirësimin e aksesit në informacion dhe lehtësimin e procedurave të aplikimit dhe regjistrimit për studentët ndërkombëtarë.

Rezultatet e pritshme përfshijnë: një rritje të dukshme të interesit dhe aplikimeve nga tregje të reja ndërkombëtare; krijimin e një sistemi funksional të ndjekjes së aplikimeve; forcimin e imazhit të UAMD si universitet mikpritës dhe bashkëkohor; si dhe ndërtimin e një kulture të qëndrueshme ndër-institucionale për mirëpritjen dhe integrimin e studentëve të huaj në jetën akademike dhe sociale të universitetit.

I. Përshkrimi i Procedurës së Aplikimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 02.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Universiteti ynë miraton cdo vit akademik kuotat e pranimit të studentëve në Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor, në programet e studimit me karakter profesional 2-vjeçar, Programin e Integruar të Studimeve, Master i Shkencave dhe Master Profesional, për vitin pasardhës. Në miratimin e kuotave për çdo program studimi, një nga nga elementët e saj është edhe kuotat sipas programit të studimit për kandidatët "Të Huaj".

Procedura e aplikimit dhe e regjistrimit për kandidatet e huaj që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në programet që zhvillohen në gjuhën angleze por edhe në programet që zhvillohen në gjuhën shqipe pranë një IAL shqiptar janë të përshkruara si më poshtë:

1. Të gjithë kandidatët me diplomë të huaj të arsimit të mesëm të lartë që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të percaktuara nga IAL-të, për çdo vit akademik, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat për këtë kategori nga IAL-te në programet e studimit që ato ofrojnë.
2. Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe plotësojnë kriteret e percaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.
3. Kandidatet, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, sipas afateve të percaktuara në Udhëzimin e MAS. Regjistrimi i këtyre kandidateve fitues bëhet me rezerve, nëse në momentin e regjistrimit nuk zoterojnë dokumentin e njohjes dhe njehsimit të leshuar nga QSHA.
4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.
5. Kandidatët duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) formularin e aplikimit sipas shtojces nr. 2. të këtij udhezimi.
 - b) kopje të dokumentit të leshuar nga Qendra e Sherbimeve Arsimore që verteton njohjen e diplomes së arsimit të mesëm të lartë, shoqëruar me kopje të diplomes/deftesës dhe listes së notave. Kandidatet që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit paraqesin vertetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

- c) kopjen e dokumentit të identifikimit.
 - d) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe). Kandidatet që kanë kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë:
 - e) dy fotografi personale;
 - f) kopjen e mandat pagesës;
 - g) deklaratën sipas shtojcës nr. 1. pjesë përberëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi.
6. Kandidatët paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-së përkatëse. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-se listat e fituesve dhe të dhenat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm.
7. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në të njejtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i studimit i IAL-se ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i paraqitjes së dëshmisë së njohjes së kesaj gjuhe të huaj.
8. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidateve fitues në bazë të kriterëve të percaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidateve dhe formulën/menyrën e përzgjedhjes. IAL-te publikojnë në mjedisë të dukshme dhe fagen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
9. Kandidatët kane të drejtën e ankimit brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-te shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.
10. IAL-te shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
11. Kandidatet regjistrohen vetëm në një nga programet e studimit ku janë spallur fitues brenda dates se percaktuar nga IAL. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.
12. Sekretaritet mësimorë në njesite kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

13. Sekretaritetë mësimore të IAL-ve mbajnë regjister të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidateve të regjistruar.

Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

II. Hapat Teknikë dhe Logjistikë të Ndjekjes së Aplikimeve

Për efekt të afateve dhe kohës së shkurtër për aplikimet e kandidatëve të huaj që kanë shfaqur interes në programet tona të studimit, do të ngrihet një komision ad-hoc për pranimet e këtyre kandidatëve, për vitin akademik 2025-2026, i cili do të përbëhet nga staf me eksperiencë nga Drejtoritë përkatëse të UAMD-së me përbërje si më poshtë:

1. Koordinator i komisionit – Specialist nga Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
2. Specialist i fushës juridike – Drejtoria Juridike
3. Specialist i fushës së njohjes së procedurave të aplikimit në UAMD- Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Specialist në fushën e karrierës – Sektori i Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit
5. Ekspert finance- Specialist në Drejtorinë e Administrimit Financiar
6. Ekspert IT – Specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit


Ky komision do të koordinohet nga Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, e cila do të ndjekë procesin e aplikimeve për studentë shtetas të huaj të cilët kanë shfaqur interes për të aplikuar në programet e studimit që UAMD ofron në gjuhën angleze. Ky proces do të zbatojë hapat e mëposhtëm:

1. Të gjitha aplikimet e studentëve të huaj do të drejtohen në adresën zyrtare të e-mailit të hapur posaçërisht (admissions@uamd.edu.al) i cili do të jetë në shërbim të studentëve të huaj vetëm për aplikimet. Kredencialet do të kalohen personit përgjegjës që do të vendoset nga Rektorati për këtë çështje. Më pas aplikimet do të përcillen në njësitet kryesore përkatëse.
2. Në faqen zyrtare të www.uamd.edu.al do të vendoset një opsion i dedikuar për studentët e huaj (Admissions UAMD). Në këtë faqe do të paraqiten të gjitha informacionet kryesore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- huaj vetëm për aplikimet. Kredencialet do ti kalohen personit përgjegjes që do të vendoset nga Rektorati për këtë çështje. Më pas aplikimet do të përcillen në njësitë kryesore përkatëse.
2. Në faqen zyrtare të www.uamd.edu.al do të vendoset një opsion i dedikuar për studentët e huaj (Admissions UAMD). Në këtë faqe do të paraqiten të gjitha informacionet kryesore që një student duhet të ketë parasysh përpara se të fillojë aplikimin, si dhe disa nga dokumentet fillestare që ai duhet të përgatisë.
 3. Asistimi për marrjen e vizës për studentët jashtë BE-së, në të cilën Njësia Koordinuese për Admissions do të publikojë listën e plotë të regjimit të vizave për të huajt në mbarë botën online tek faqja e dedikuar, por gjithashtu do t'ua përcjellë edhe me e-mail studentëve të interesuar linkun:
<chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://punetejashtme.gov.al/ëp-content/uploads/2024/09/2-REGJIMI-I-VIZAVE-PER-TE-HUAJT-18.09.2024.pdf>
 4. **Mbështetje për procesin e marrjes së vizës**
 - 4.1 Përgatitja dhe sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin e vizës studentore.
 - 4.2 Ofrimi i kontakteve me ambasadat dhe konsullatat shqiptare në vendet e origjinës së studentëve.
 - 4.3 Krijimi i një linje kontakti në universitet për ndihmë dhe përgjigje pyetjesh gjatë procesit të aplikimit për vizë.
 - 4.4 Sipas rastit për çdo aplikim, do të orientohet studenti kandidat sipas vendit përkatës duke garantuar komunikimin me Ambasadën shqiptare në atë vend
 5. **Mbështetje për njësimin e Diplomës në sistemin e QSHA-së**
 - 5.1 Duke qenë se studentët e huaj që aplikojnë në programet e studimit në UAMD vijnë nga sisteme të ndryshme arsimore, është e domosdoshme që diplomat e tyre të shkollës së mesme të njësohen (nostrifikohen) sipas standardeve të sistemit arsimor shqiptar. Ky proces realizohet përmes Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe është një parakusht për regjistrimin zyrtar të studentit në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri.
 - 5.2 Llojet e mbështetjes së propozuara nga UAMD
Për të lehtësuar këtë proces për studentët e huaj, UAMD propozon të ofrojë mbështetje të strukturuar në këto forma:
 - Udhëzim dhe asistencë administrative për plotësimin e aplikimit për njësim (nëpërmjet zyrës së koordinimit për admissions)
 - Duke qenë se nuk ndodhen fizikisht në Shqipëri, asistencë për procedurën për Njësimi i diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, aplikim që bëhet online në portalin e-albania



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853

- Asistencë për ndjekjen e statusit të aplikimit për njësim dhe komunikimi me QSHA në emër të studentit në rast të kërkesave shtesë apo paqartësive.

6. Informacion për tarifat e studimit dhe procedurat për përfitimin e bursës

Shtetasit e huaj të cilët do të vazhdojnë studimet pranë universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në një program të parë ose të dytë studimi, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë të cilët vijojnë studimet në programet respektive, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit për këto studentë.

Sipas VKM Nr. 903, datë: 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", kriteret e përfitimit të bursës janë si me poshte:

1. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike
2. Bashkëshortët që kanë fëmijë, dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili burse financiare
3. Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
4. Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar).
5. Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë
- 5/a. Studentët që kanë njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton.
6. Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve të lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë.
7. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç
8. Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç

Nuk përfitojnë bursë ose e humbasin të drejtën e përfitimit të saj:

- i. Vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS


- ii. Nuk e kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit (studentët përsëritës)
7. Për tu ardhur në ndihmë studentëve të huaj, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2025-2026, me kërkesë të studentëve, do të ofrojë mësimin e Gjuhës Shqipe :
- A-në formën e kursit intensiv, apo veprimtari të ngjashme nga Departamenti i Gjuhës Shqipe (FE)
- B-si mundësi që programi i lëndës "Gjuhë Shqipe" të jetë pjesë e kurrikulës së programit të studimit që ata ndjekin, në mënyrë që studenti të ketë mundësi ta përzgjedhë atë.
8. Rekomandime dhe asistencë për akomodimin.
- Duke qenë se UAMD nuk ofron dot mundësi strehimi për studentët të huaj apo që vijnë nga rrethet, Njësia Koordinuese për mbështetjen e studentëve të huaj do të vë në dispozicion informacion të detajuar mbi mundësitë e akomodimit në Durrës, duke ofruar ndihmë nëse studenti ka nevojë për mbështetje konkrete për të gjetur banesë me qira ose strehim alternativ.

III. Menaxhimi i Komunikimit dhe Promovimit

Për të rritur vizibilitetin dhe qartësinë e informacionit për studentët e huaj, është e nevojshme të krijohen materiale të strukturuar dhe profesionale, në gjuhën angleze dhe shqipe. Këto do të përfshijnë broshura, katalogë informues dhe materiale digjitale që prezantojnë programet e studimit, kriteret e pranimit, procedurat e aplikimit dhe informacion mbi jetën studentore. Faqja zyrtare e UAMD-së do të përditësohet me një rubrikë të dedikuar për studentët ndërkombëtarë, duke shërbyer si burimi kryesor i informacionit zyrtar. Gjithashtu, rrjetet sociale dhe platformat online do të përdoren si mjete efikase për komunikim dhe promovim të vazhdueshëm.

Informacion për UAMD-në, jetën studentore, qytetin e Durrësit etj është krijuar një broshurë udhëzuese në anglisht që do t'i shpërndahet çdo kandidati të interesuar që në momentin e pare të komunikimit me të në kanalet zyrtare të komunikimit të UAMD-së, email, social media.

Universiteti do të angazhohet në promovimin e programeve të studimit përmes pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare të arsimit dhe evente të tjera të ngjashme. Në bashkëpunim me ambasadat shqiptare jashtë vendit dhe agjencitë edukative, do të synohet përhapja e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

informacionit në mënyrë të gjerë dhe të besueshme. Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DPMJ) do të organizojë çdo pranverë aktivitetin 'International Week', me qëllim promovimin e programeve dhe shkëmbimin akademik. Gjithashtu, çdo vit do të dërgohet një njoftim zyrtar ambasadave shqiptare për programet e reja në gjuhën angleze që ofron UAMD.

Për çdo student të huaj do të caktohet një specialist përgjegjës nga DPMJ për të ofruar asistencë të drejtpërdrejtë gjatë gjithë periudhës së studimeve. DPMJ do të ofrojë gjithashtu sugjerime me një listë biznesesh që ofrojnë mundësi punësimi gjatë kohës së studimeve dhe do të sigurojë mbështetje logjistike për pritjen në aeroportin e Rinasit dhe shoqërimin deri në destinacion.

Në mënyrë që të sigurohet integrimi i plotë i studentëve të huaj në ambientin universitar dhe shoqëror, DPMJ do të organizojë një kontakt të rregullt me ta. Në të premtën e fundit të çdo muaji, do të realizohen kontakte individuale për të vlerësuar gjendjen, problematikat e mundshme dhe vijueshmërinë e procesit mësimor, duke ofruar ndihmë sipas nevojës.


IV. Zgjidhje e Përkohshme dhe Sistemi i Synuar

Duke qenë se ndërtimi i një sistemi të plotë CRM për ndjekjen e aplikimeve kërkon kohë për analizë dhe zhvillim teknik, propozojmë një zgjidhje të përkohshme manuale, e cila do të mundësojë funksionimin efektiv të procesit që në këtë fazë të parë.

1 -> Në faqen zyrtare të www.uamd.edu.al do të vendoset një opsion i dedikuar për aplikimet e studentëve të huaj. Në këtë faqe do të paraqiten të gjitha informacionet kryesore që një student duhet të ketë parasysh përpara se të fillojë aplikimin, si dhe disa nga dokumentet fillestare që ai duhet të përgatisë.

2 -> Ne kemi hapur një email në Google eöorkspace (admissions@uamd.edu.al), i cili do të jetë në shërbim të studentëve të huaj vetëm për aplikimet. Kredencialet do t'i kalohen personit përgjegjës që do të vendoset nga Rektorati për këtë çështje.

3 -> Ne sugjerojmë që për çdo aplikim të hapet një folder në Google Drive, në të cilin përfshihen të gjitha dokumentet e studentit, një dokument me të gjitha shënimet (notes, reminders etj.) që mund t'i duhen personit përgjegjës për të ndjekur procesin. Gjithashtu, mund të mbahet një kalendar me takimet virtuale online.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

4 -> I gjithë Drive të bëhet backup të paktën një herë në javë për arsye sigurie.

5 -> Duke qenë se studentët e huaj e kanë të pamundur të bëjnë pagesa fizikisht pranë postës dhe bankave të nivelit të dytë, ne sugjerojmë integrimin e një pagese online. Sugjerojmë që të merret një pagesë ekstra edhe për shërbimet ndërmjetëse që mund të bëjë UAMD (p.sh.: të paguajmë faturat e QSHA-së të studentit).

Kjo është një zgjidhje provizore deri në zhvillimin e sistemit të mëposhtëm:

Teknologjia e zgjedhur:

• Backend:	PHP	-	Laravel
• Frontend:	Vue.js	/	PHP
• Database: MySQL			

Sistemi do të jetë i ndërtuar me versionin më të fundit të PHP/Laravel Framework (Laravel 12).


Të gjithë modulet do të jenë **auth protected**, që do të thotë nuk do të jenë të aksesueshme pa u loguar me kredencialet përkatëse (përveç faqeve që ne do t'i lëmë publike, që përmbajnë informacionin fillestar).

Cikli dhe logjika që duhet të ndiqet kryesisht është:

- Regjistrimi i studentit në portal (kjo bëhet pa i kërkuar shumë dokumente fillestare)
- Dërgimi i aplikimit
- Vlerësimi i aplikimit
- Vendimmarrja (pranim/refuzim)
- Pagesa
- Ndjekja pas pranimi (folloë-up)

Sistemi do të jetë i ndërtuar në 2 tipe përdoruesish, të cilët janë:

1. **Studentët** → Regjistrohen dhe bëjnë aplikimet në degët përkatëse
2. **Përdoruesit e sistemit** → Këtu do të jenë të gjithë përdoruesit e lejuar nga UAMD për të ndjekur dhe menaxhuar sistemin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Studentët do të kenë mundësi të ndjekin në kohë reale statusin e aplikimit të tyre, dokumentet që kërkohen, mesazhet e lëna nga personi që po i ndjek, faturat, etj.

Portali i përdoruesve të sistemit është më kompleks se kaq. I gjithë aksesimi është i kufizuar në bazë të roles and permissions. Jo të gjithë kanë të njëjtin akses.

Modulet e menduara janë:

- 1 -> Roles and permissions
- 2 -> System Users
- 3 -> Programet e Studimit
- 4 -> Financa
- 5 -> Studentët
- 6 -> Komunikimet
- 7 -> Reminders & Notes
- 8 -> Historiku i komunikimeve
- 9 -> Ndjekja e procesit
- 10 -> Statistika

(bashkëlidhur dokumentit do të gjenden aneksi me përmbajtjen e faqes që do të krijohet për admissions)

Koordinatori i komisionit ad-hoc i përcjell më pas njësisë kryesore të UAMD-së gjithë procedurën e aplikimit për vijimin e regjistrimit të aplikantëve studentë të huaj brenda afateve të përcaktuara në ligj.

V. Baza Ligjore e VKM Nr.858, date 29.12.2021

Baza Ligjore

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 88; në Ligjin nr. 79/2021 "Për të huajt" neni 3 dhe 46; në VKM nr. 279, datë 21.05.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

në Vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; Statutin e UAMD-së neni 73 pika 2 dhe Rregulloren e UAMD-së neni 44 pika 6 shkronja c.

Rregulla te përgjithshme mbi pajisjen dhe ripërtëritjen e lejes së qëndrimit

Referuar Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", sqarohet së pari termi "Student" në kuptim të këtij Ligji, në nenin 3 pika 43 përcaktohet: "Student" është i huaji, i cili është pranuar nga një institucion i arsimit të lartë dhe që është pranuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllimin kryesor për të ndjekur një program studimi të plotë, që çon në arritjen e një kualifikimi të arsimit të lartë, duke përfshirë diploma, certifikata ose diplomë të gradës shkencore "Doktor" nga një institucion i arsimit të lartë, i cili mund të përfshijë edhe një kurs përgatitje paraprak, në përputhje me legjislacionin kombëtar ose një trajnim të detyrueshëm".

Sipas Nenit 46 të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", përcaktohet që: I huaji, i cili ka hyrë dhe qëndron në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi pranë një institucioni arsimor publik apo privat të njohur nga shteti shqiptar, ka të drejtë të aplikojë për leje qëndrimi sipas kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 36 dhe 37 të këtij ligji. I huaji, i pranuar në një institucion arsimor ose që merr pjesë në trajnime ose praktika profesionale, pajiset me leje qëndrimi, me afat jo më shumë se një vit kur lëshohet për herë të parë dhe mund të shtyhet çdo herë me një vit deri në përfundimin e shkollës, të studimeve ose të praktikës. Në rast se kohëzgjatja e kursit është më e vogël se një vit, afati i lejes së qëndrimit është i barabartë me kohëzgjatjen e kursit. I huaji duhet të provojë se është pranuar nga institucioni arsimor, se ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës së shkollimit ose trajnimit, si dhe disponon mjete financiare të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë gjatë studimeve. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, përveç të tjerash, i huaji duhet të provojë mbi progresin e bërë në drejtim të studimeve, sipas legjislacionit në fuqi. I huaji, i pajisur me leje qëndrimi si student, pas vitit të parë të studimeve, jashtë kohës së tij të studimit, në bazë të lejes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

përkatëse të punës, ka të drejtë të punësohet dhe mund t'i jepet e drejta e ushtrimit të aktivitetit të vetëpunësimit, duke respektuar limitin maksimal 15 orë në javë, ose ekuivalenti me ditë ose muaj në vit, pa miratimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Punëdhënësi i tij njofton autoritetet shtetërore përgjegjëse për punësimin, për fillimin dhe përfundimin e punësimit. Gjatë periudhës së studimeve, leja e qëndrimit për studentin nuk mund të zëvendësohet në leje qëndrimi për motiv punësimi. Pas përfundimit të studimeve, i huaji, nëse plotëson kushtet për punësim sipas kriterëve të këtij ligji, mund të aplikojë për leje unike (sipas Seksionit V të këtij Ligji).

Dokumentacioni për pajisjen me vizë të tipit D/ST

Bazuar në VKM nr. 858/2021 të ndryshuar dhe Ligjin nr. 79/2021, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për vizë për qëllime studentore të tipit D/ST, për studentët që vijnë nga shtetet për të cilët nevojitet viza, sipas aneksit nr. 3 dhe 4 të këtij Vendimi, janë:

- Formulari i aplikimit për vizë D/ST, sipas modelit të përcaktuar në **Aneksin nr. 5** të VKM nr. 858/2021, i plotësuar dhe i nënshkruar nga aplikuesi, i cili gjendet on-line pa pagesë (formulari plotësohet on-line dhe shkarkohet nga sistemi) <https://e-visa.al/apply> ;
- Fotografia e aplikuesit, e bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marë në plan me sfond të bardhë, e fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.
- Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit me vlefshmëri së paku 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Vetëdeklarim për akomodim të përshtatshëm, i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare; Për studentët e huaj, vetëdeklarimi lëshohet nga vetë studentët e huaj. Gjithashtu, në mungesë të këtij vetëdeklarimi, vërtetimi i akomodimit mund të lëshohet nga institucioni i arsimit të lartë, nëse ky i fundit ofron shërbimin e akomodimit për studentët ose mund të lëshohet nga subjekte të tjera, që ofrojnë këtë shërbim;
- Dokumenta shtesë sipas përcaktimeve të publikuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si më poshtë:
 1. Dokumenti që vërteton regjistrimin/pranimin në një institucion arsimor shqiptar;
 2. Garanci që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe shkollimit;
 3. Dokumenti i sigurimit shëndetësor, që përkon me kohëzgjatjen e qëndrimit;
 4. Dokumentin që vërteton strehimin në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 5. Dokumenti që provon njohjen e gjuhës me të cilën do të kryej studimet;
 6. Kopje të vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore (Dëshmia e Penalitetit) e Legalizuar sipas regjimit me shtetin që e ka lëshuar këtë dokument.

Gjithashtu, për studentët e huaj që aplikojnë nga vende në të cilat nevojitet pajisja me vizë, bazuar në nënpikën 3.5 të Kreut II, ndarja "C" të VKM nr. 858/2021 të ndryshuar me VKM nr. 279, datë 21.05.2025, përcaktohet dokumentacioni shtesë për vizë për motive studimi si më poshtë:

- a) Dokumenti, që vërteton pranimin në një institucion arsimor shqiptar pas verifikimit të dokumentacionit shkollor të të huajit nga institucioni i arsimit të lartë;
- b) Dëshmia financiare, që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit në vlerën 300 000 lekë në një bankë në vendin e origjinës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

c) Dëshmia e njohjes së gjuhës së programit të studimit/gjuhës së zhvillimit të procesit mësimor apo vërtetimi për pranimin në kursin përgatitor të gjuhës.

Dokumentacioni për leje qëndrimi për motive studimi


Bazuar në VKM nr. 858/2021 të ndryshuar dhe Ligjin nr. 79/2021, kriteret dhe dokumentacioni i përgjithshëm për pajisje me leje qëndrimi nga studentët e huaj, janë:

- Formulari i aplikimit për motive studimi (sipas **Aneksit nr. 9** të VKM nr. 858/2021)

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9628

- Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit me të cilin i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, si dhe fotokopjen e faqeve me shënime me interes për udhëtimin, si dhe gjenealogjet e mbajtësit, viza e tipit "D", vulat në hyrje-dalje;
- Fotografia e aplikuesit, e bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marë në plan me sfond të bardhë, e fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.
- Dokumente që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare;
- Dokument vërtetues për burime të tjera që rrjedhin nga një grant, një bursë studimi, një kontratë e vlefshme pune ose një ofertë pune, jo më pak se 300 mijë lek për person, për 1 (një) vit kalendarik;

26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

- Vlera e tarifës së shërbimit për lejen e qëndrimit për motive studimi, kur aplikohet për herë të parë është 4500 lekë, ndërsa në rast ripërtëritje është gjysma e vlerës së tarifës së parë 2250 lekë (sipas aneksit nr. 6 të VKM nr. 858/2021).

Dokumentacion shtesë për motive studimi:

1. Dokumenti i pranimi nga një institucion arsimor në Shqipëri;
2. Paraqitja e një vërtetimi depozite bankare personale në bankat e nivelit të dytë, në Shqipëri, jo më pak se 300 000 lekë për person (për 1 (një) vit kalendarik) ose të një dokumenti vërtetues për burime të tjera që rrjedhin nga një grant, një bursë studimi, një kontratë e vlefshme pune ose ofertë pune, jo më pak se 300 000 mijë lekë për person, për 1 vit kalendarik;
3. Dëshmia e njohjes së gjuhës të programit të studimit/gjuhës së zhvillimit të procesit mësimor apo vërtetim për pranimin në kursin përgatitor të gjuhës;
4. Vërtetim se janë paguar tarifat e vendosura nga institucioni i arsimit të lartë
5. Vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë, ku ndjek studimet i huaji për pajisjen me numër matrikullimi

Sqarim:

Ø Institucionet arsimore/institucionet e arsimit të lartë raportojnë, në formë shkresore ose elektronike, si vijon:

a) Dërgojnë informacion periodik çdo 6 (gjashtë) muaj dhe në çdo kohë kur kërkohet nga autoritetet vendore për kufirin dhe migracionin, lidhur me frekuentimin e procesit mësimor të studentëve të huaj të pranuar për të ndjekur programet arsimore, si

26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

dhe menjëherë në rastet kur marrin dijeni mbi informacione që mund të sjellin si pasojë anulimin e vizës;

b) Dërgojnë informacion, në çdo kohë pranë autoriteteve vendore për kufirin dhe migracionin, lidhur me problematikat e hasura me studentët e huaj;

c) Njoftojnë menjëherë autoritetet vendore për kufirin dhe migracionin lidhur me rastet e studentëve të huaj, që kanë ndaluar së ndjekuri përkohësisht apo përfundimisht studimet.

Ø Përrjashtohen nga pagesa e tarifës së shërbimit për pajisjen me leje qëndrimi shtetasit e Republikës së Kosovës, si dhe shtetasit e përkatësive etnike shqiptare të republikave të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, që qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi. Shtetasi aplikues ka detyrimin të paguajë vetëm vlerën e dokumentit biometrik, leje qëndrimi

Shtojca nr. 1

Procedura e Aplikimit për Leje Qëndrimi për Studentët e Huaj në Shqipëri

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/DPPSH/15146/15308_LQ_dokumentacioni.pdf


Hapi 1: Përgatitja e Dokumenteve të Nevojshme

Studenti duhet të përgatisë paketën e mëposhtme të dokumentave, të cilat do të dorëzohen në Zyrën e Emigracionit:

1. Pasaporta e vlefshme me afat të paktën 6 muaj nga data e aplikimit.
2. Letra e pranimi zyrtar nga universiteti shqiptar (origjinal dhe kopje).



20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

3. Formulari i plotësuar i aplikimit për leje qëndrimi (mund të merret nga Zyra e Emigracionit ose në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme).
4. Fotografi me përmasa të përcaktuara (47x36 mm, në ngjyra, bërë 6 muajt e fundit).
5. Dëshmi e sigurimit shëndetësor që mbulon periudhën e qëndrimit në Shqipëri.
6. Dëshmia e banimit të përshtatshëm në Shqipëri, e cila mund të jetë:
 - o Kontratë qiraje e firmosur me qiradhënësin (e noterizuar nëse kërkohet).
 - o Certifikatë banimi ose dokument tjetër ligjor që provon vendbanimin.
7. Dëshmia e burimit financiar për mbajtjen gjatë qëndrimit (deklaratë bankare, bursë, ose dokumentacion tjetër financiar).
8. Tarifa e aplikimit për lejen e qëndrimit (sipas ligjit dhe udhëzimeve të zyrës së emigracionit).

Hapi 2: Dorëzimi i Dokumenteve në Zyrën e Emigracionit

- Studentët duhet të paraqiten personalisht në Zyrën e Emigracionit në Durrës (ose qytetin ku ndodhen).
- Dorëzimi i dosjes me të gjitha dokumentet e përgatitura.
- Mbajtja e një numri protokollit të dorëzimit të dokumenteve për ndjekje.

Hapi 3: Verifikimi dhe Kontrolli i Dokumentacionit

- Zyra e Emigracionit kontrollon dokumentacionin për plotësinë dhe saktësinë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Mund të kërkohen sqarime ose dokumente të tjera shtesë nga studenti brenda një periudhe të caktuar.
- Nëse dokumentet janë të kompletuara, fillon procesi i shqyrtimit të aplikimit.

Hapi 4: Intervista dhe Marrja e Vendimit

- Në disa raste, Zyra e Emigracionit mund të thërrasë studentin për një intervistë për të verifikuar qëllimin e qëndrimit.
- Pas përfundimit të shqyrtimit, lëshohet vendimi për dhënien ose refuzimin e lejes së qëndrimit.

Hapi 5: Marrja e Lejes së Qëndrimit

- Nëse leja aprovohet, studenti duhet të paraqitet personalisht për të marrë dokumentin fizik (kartën e qëndrimit).
- Kartat zakonisht janë me afat njëvjeçar dhe rinovohen për çdo vit studimi.
- Ruajtja e dokumentit është shumë e rëndësishme gjatë qëndrimit në Shqipëri.

Hapi 6: Rinovimi i Lejes së Qëndrimit

- Para skadimit të lejes aktuale (të paktën 30 ditë më parë), studenti duhet të aplikojë për rinovim.
- Procesi i rinovimit kërkon tërësinë e dokumenteve të përditësuara, përfshirë dëshmi të vazhdimit të studimeve në universitet.
- Rinovimi bëhet në të njëjtën Zyrë Emigracioni.

Ø Këshilla të Rëndësishme



22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

- Studentët duhet të fillojnë procesin e aplikimit për leje qëndrimi menjëherë pas mbërritjes në Shqipëri.
- Mungesa e lejes së qëndrimit mund të sjellë gjoha ose probleme ligjore.
- UAMD dhe në veçanti Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DPMJ) duhet të asistojnë studentët gjatë gjithë këtij procesi.
- Çdo ndryshim në banim, status, ose program studimi duhet të njoftohet menjëherë në Zyrën e Emigracionit.


VI. Përfundime dhe Rekomandime

Strategjia afatshkurtër për rekrutimin e studentëve të huaj për vitin akademik 2025–2026 përfaqëson një ndërhyrje të domosdoshme dhe të strukturuar për të nisur procesin e ndërkombëtarizimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Ajo përfaqëson një qasje pragmatike dhe funksionale për t'i dhënë përgjigje interesit në rritje të studentëve të huaj, duke ngritur një mekanizëm të përkohshëm menaxhimi dhe koordinimi për aplikimet dhe ndjekjen e tyre.

Zbatimi i kësaj strategjie do të mundësojë ndërtimin e praktikave të menaxhimit që nuk kanë ekzistuar më parë në mënyrë të institucionalizuar në UAMD. Megjithatë, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e saj, është e nevojshme mbështetja e plotë institucionale nga strukturat drejtuese të universitetit dhe angazhimi i burimeve të nevojshme njerëzore dhe teknologjike.

Rekomandohet:

1. Të miratohet strategjia në Senatin Akademik, në mënyrë që të fillojë zbatimi i saj për vitin akademik 2025–2026.
2. Në një perspektivë afatgjatë të shikohet mundësia e krijimit të një strukture të përhershme për pranimin dhe ndjekjen e studentëve të huaj, si pjesë e një drejtorie ose zyre të specializuar për vazhdimësinë e këtij shërbimi me rëndësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

3. Të ndërtohet dhe pilotohet sistemi CRM i përshkruar, në mënyrë që eksperiencia e këtij viti të shërbejë si themel për kalimin në një zgjidhje të plotë digjitale.
4. Të alokohet një buxhet i dedikuar për komunikimin ndërkombëtar, pjesëmarrjen në panairë dhe trajnimin e stafit për menaxhimin e studentëve të huaj.
5. Të krijohet një "Klub Studentor Ndërkulturor"
6. Të rishikohet dhe përditësohet çdo vit strategjia bazuar në rezultatet dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit.

Grupi i Punës

Suela Kastrati - kryetar

Ina Lushka - anëtar

Bledar Kurti - anëtar

Spiro Paço - anëtar

Aljona Kërçuku - anëtar

Etleva Laçi - anëtar

Danjel Kalari - anëtar (student)

STRUKTURA E FAQES SË WEBI-T DEDIKUAR ADMISSIONS PËR INTERNATIONAL STUDENTS

Kriteret e Pranimit për Programet Bachelor të Ofruara në Gjuhën Angleze

1. Studentët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ose një diplomë ekuivalente
2. Një mesatare minimale nga shkolla e mesme (CGPA) prej 7.00 nga 10.00 ose një mesatare ekuivalente.
3. Nivel i aftësisë në gjuhën angleze B1 sipas CEFR.

Kriteret e Pranimit për Programet e Bachelor në Gjuhën Shqipe

1. Studentë që kanë përfunduar shkollën e mesme ose një diplomë ekuivalente.
2. Një mesatare minimale nga shkolla e mesme (CGPA) prej 6.50 nga 10.00 ose një mesatare ekuivalente.

Shënime rreth provimit të aftësisë në anglisht

Niveli i njohurive të gjuhës angleze B1 sipas CEFR në një nga provimet e mëposhtme:

1. Cambridge
2. IELTS
3. Testi TOEFL i bazuar në internet (iBT)
4. Testi TOEFL me letër (ITP)
5. TOEIC
6. GESE
7. APTIS (4 aftësi)

Në rastet kur Studenti ka përfunduar studimet në një shkollë të mesme ku mësimdhënia zhvillohet tërësisht në anglisht, ai përjashtohet nga detyrimi për të paraqitur këtë dokument.

“Aleksandër Moisiu” ofron një sërë programesh Bachelor, Master dhe Doktoraturë në Fakultetin e Biznesit dhe Edukimit, Fakultetin e Shkencave Politike dhe Drejtësisë, Fakultetin e Studimeve Profesionale dhe Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.

Regjistrimi i studentëve me kualifikime të larta është një përparësi kryesore e UAMD-së. Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë disa kriteret për t'u pranuar. UAMD nuk diskriminon asnjë aplikant në bazë të moshës, gjinisë, origjinës kombëtare ose aftësisë së kufizuar.

Stafi akademik i Universitetit, i cili ka përfunduar studimet në universitete prestigjioze të ndryshme ndërkombëtare dhe ka përvojat e tij të vlefshme në mbarë botën, siguron që cilësia e mësimdhënies të jetë në nivele të larta.

Procedurat e Regjistrimit për Studentët e Nivelit të Parë

- Studentë të huaj



STRUKTURA E FAQES SË WEBI-T DEDIKUAR ADMISSIONS PËR INTERNATIONAL STUDENTS

Shtetasit e huaj dhe shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar studimet e shkollës së mesme jashtë Republikës së Shqipërisë

1. Kandidatët aplikojnë vetë ose nëpërmjet një personi të autorizuar pranë Komisionit të Posaçëm të Agjencisë Kombëtare të Provimeve të Republikës së Shqipërisë për të marrë *dokumentin mbi ekuivalentimin e studimeve të shkollës së mesme* duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:
 - Formular Aplikimi i Plotësuar;
 - Kopje e Kartës së Identitetit;
 - Kopje e noterizuar e Diplomës së Shkollës së Mesme e përkthyer në shqip;
 - Kopje e noterizuar e Listës së Notave të Shkollës së Mesme e përkthyer në shqip;
 - Kopje e noterizuar e dokumentit që vërteton se kandidati ka kaluar me sukses provimet ekuivalente me provimet e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë (Provimet Panhelenike – Greqi; certifikatë – Itali; certifikatë për pikët e marra në çdo provim kursi – Kosovë; Provimet e Maturës Shtetërore etj.).
1. Komisioni i Posaçëm i Agjencisë Kombëtare të Provimeve të Republikës së Shqipërisë shpall rezultatet dhe lëshon dokumentin mbi ekuivalencën e studimeve të shkollës së mesme.
2. Kandidatët aplikojnë pranë Zyrës së Pranimi të "UAMD" me dokumentet e përmendura më lart.
3. UAMD shpall listën e fituesve për secilin program studimi.
4. Kandidatët kryejnë regjistrimin përfundimtar në programin e studimit ku janë shpallur fitues duke paraqitur vetë ose nëpërmjet një personi të autorizuar dokumentet e regjistrimit.

Dokumentet e Regjistrimit për Studentët e ciklit të parë

- Studentë të huaj

Të gjithë studentët duhet të paraqesin personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar dokumentet e mëposhtme për të përfunduar regjistrimin e tyre përfundimtar në UAMD.

Dokumentet e kërkuara:



STRUKTURA E FAQES SË WEBI-T DEDIKUAR ADMISSIONS PËR INTERNATIONAL STUDENTS

- Kopje origjinale e diplomës së shkollës së mesme dhe listës së notave, me vulë apostile, e noterizuar.
- Kopje e noterizuar e Ekuivalencës së Diplomës.
- Fotokopje e Pasaportës.
- Certifikatë e gjuhës angleze.
- Kopje e noterizuar e lejes së qëndrimit.
- 3 Fotografi.
- Faturë pagese.

